Kronikë

Tiranë/ Babë e bir arrestohen për armë dhe kokainë në shtëpi! 76-vjeçari tentoi të hidhte drogën në lavaman, ndërsa pistoletën e hodhi nga ballkoni (EMRAT+VIDEO)

Një 37 vjeçar dhe babai i tij ranë në prangat e policisë së Tiranës pasi në banesë iu gjetën armë zjarri, municion luftarak dhe kokainë

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
26 Janar, 12:03 | **Përditesimi: 26 Janar, 12:46**

Share

Tiranë-Një 37 vjeçar dhe babai i tij ranë në prangat e policisë së Tiranës pasi në banesë iu gjetën armë zjarri, **municion luftarak** dhe kokainë.

> *"U bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasve:*
>
> ***Renaldo Zajmi** 37 vjeç, për veprat penale "Armëmbajtja pa leje" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" dhe Bajram Zajmi, 65 vjeç, (babai i shtetasit Renaldo Zajmi), për veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës", të dy banues në Tiranë", informoi sot policia.*

LEXO EDHE:
Shisnin kokainë dhe kanabis në qytetin e Vlorës, 2 të arrestuar

Sipas njoftimit të bluve, fillimisht efektivët ndaluan, Renaldo Zajmin për një kontroll automjeti në rrugën "Niko Avramo", ku gjetën një sasi lëndë narkotike të dyshuar kokainë.

Ndërkohë babai i tij në momentin që ka parë policinë ti afrohen banesës tentoi të hedh lëndën narkotike në lavaman, teksa hodhi nga ballkoni armën e zjarrit, thuhet më tej në njoftimin e policisë.

Në cilësinë e provës materiale sekuestruan 1 armë zjarri pistoletë, municion luftarak dhe një sasi të dyshuar lëndë narkotike kokainë, e ndarë në doza, gati për shitje, me peshë totale rreth 36 gramë.

Siç shihet edhe nga video e publikuar nga Policia, lëndën narkotike ata e fshihnin në një çokollatë në formë veze.

Operacioni u kodua "Midnight".

Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme procedurale.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: kokaine | municion luftarak | arme zjarri | Renaldo Zajmi | Bajram Zajmi | Tirane

Komento

Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
25 Janar, 13:37
A duhet të votojnë emigrantët që kanë vetëm dokumente identifikimi të huaja?
Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

GJKKO e dënoi me 1 vit burg për korrupsion në zgjedhje, Kryebashkiaku i Rrogozhinës, Memolla: S'iki nga posti pa vendim të formës së prerë
26 Janar, 12:27

Ish-presidenti Moisiu mesazh partive në prag të zgjedhjeve të 11 majit: Mendoni për Shqipërinë më shumë se për karriget
26 Janar, 12:18

Tiranë/ Me armë në brez lëvizte me makinë në rrugën "Pjetër Bogdani", me video momenti i arrestimit (EMRI+VIDEO)
26 Janar, 10:53

Itali/ Korrieri shqiptar kapet me 11 kg kokainë në autostradën e Bolonjës! Nervozizmi tradhtoi 25-vjeçarin, vlera e drogës rreth 1 mln euro
25 Janar, 22:35

Tentoi të trafikojë në SHBA 1 ton kokainë më 2023, SHBA i kërkojnë Shqipërisë kolumbianin e arrestuar në laboratorin e Fushë-Krujës
25 Janar, 20:23

Tiranë/ Sërish zjarr në pallatet e kompleksit 'Kika' te 'Komuna e Parisit'! Merr flakë garazhi, shkak kompresori i frigoriferit të një marketi! Evakuohen banorët, mes tyre fëmijë (VIDEO)
25 Janar, 18:31

'Giro d'Italia' në Tiranë, Veliaj pret Presidentin e Federatës Evropiane të Çiklizmit: Do shkëlqejmë sërish! Enrico Della Casa: Tirana, në rrugën e duhur
25 Janar, 17:06

Tiranë/ Shpërndante kokainë dhe hashash në zonën e "Astirit", arrestohet 29-vjeçari! Një pjesë e drogës gjendet në biznesin e tij (VIDEO)
25 Janar, 17:00

Tiranë/ I shpallur në kërkim nga Italia për pjesëmarrje në organizatë kriminale, arrestohet 40-vjeçari
25 Janar, 15:31

Vdekja e 12-vjeçarit, nëna e Leo Sadikut me lot në sy kërkon drejtësi! Mjekët e morën në qafë, e trajtuan vetëm për virozë

Armand Braho

25 Janar, 15:22

Kamëz/ Qarkullonte i armatosur me makinë, 'Flagranca' prangos 28-vjeçarin, nën hetim edhe shoku i tij pasagjer (VIDEO)
25 Janar, 15:22

Fier/ Shiste kokainë në doza në Divjakë, arrestohet në flagrancë 27-vjeçari
25 Janar, 14:23

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje